

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Something” shpk**

Në Tiranë, sot më datë 14.06.2019, unë e poshtëshënuar:

1- Ester Nuriu, e datëlindjes 03.11.1994, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Leternjoftim ID, me numër personal J46103057T,

me cilësinë e “ ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “Something” shpk,

*Neni 1*  
*Emri, Forma*

Shoqëria do të ketë emrin “Something”, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

*Neni 2*  
*Personaliteti juridik*

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

*Neni 3*  
*Selia*

Shoqëria e ka seline në adresë: Rruga “Vaso Pasha”, Ap. Nr.3/1, zona kadastrale 5270, numri pasurise 3/64-N/1, Tiranë

*Neni 4*  
*Objekti i veprimtarisë*

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Shitje me pakicë të bizhuterive.

*Neni 5*  
*Kohëzgjatja*

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

*Neni 6*  
*Kapitali themeltar*



Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 10.000 lekë, i ndarë 1 kuotë, i cili zotërohet si më poshtë:

Ester Nuriu, zotëron 1 kuotë me vlerë 10 000 lekë, e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9  
Administrimi

Administratorë të shoqërisë janë:

- Ester Nuriu, e datëlindjes 03.11.1994, indur në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Leternjoftim ID, me numër personal J46103057T, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.

Neni 10  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislativit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11  
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues i shoqërisë tregtare "Something" shpk , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES**

Ester Nuriu

